



Adminstrata e përkohshme e Kombeve
të Bashkuara
Misioni në Kosovë
UNMIK



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA



Administrata Civile
Shtylla II
ZYRA PËÇËSHTJE TË
KOMUNITETEVE

Departamenti
I
Demokratizimit

Zyra Këshilldhënëse
e Kryeministrit të
Komuniteteve

Vlerësimi i komisioneve komunale për komunitete (KK)

Standard: “Mekanizmat ekzistues të komunave përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve (zyrat komunale për komunitete, kuvendet komunale dhe komitetet për komunitete dhe ndërmjetësim) posedojnë resurse adekuate dhe staf si dhe funksionojnë me efikasitet.”

Gjashtëmbëdhjetë muaj pas zgjedhjeve komunale të tetorit të vitit 2002, komitetet për komunitete ende nuk e kanë arritur nivelin e kënaqshëm të performancës në shumicën e komunave të Kosovës. Raporti i tanishëm i përgatitur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK), Departamenti i Demokratizmit (OMiK DD), në bashkëpunim me Zyrën e UNMIK-ut për Çështje të Komuniteteve, (UNMIK ZÇK) dhe me Zyrën Këshillimore të Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve pranë IPVQ-ve (IPVQ ZKK), vë në pah tri shkaqe që i pengojnë komitetet të funksionojnë me efikasitet. Në këtë raport, bazuar në analizën që u është bërë këtyre arsyeve, propozohen një numër rekomandimesh mbi atë se si Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-ja) dhe UNMIK-u duhet të merren me të metat e identifikuara.

I. Të dhëna të përgjithshme

Sipas Rregullores 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, Komiteti për Komunitete (KK-ja) është njëri nga komitetet e detyrueshme, të cilin çdo komunë duhet ta themelojë¹. Krahas Komisionit për Ndërmjetësim (KN) dhe zyrave për komunitete, KK-së i është dhënë autoriteti që, si **mekanizëm kundër diskriminit**, të sigurojë që çdo komunitet, pavarësisht nga shtrirja territoriale, gjuha, feja, prejardhja etnike apo çfarëdo karakteristike tjetër e pjesëtarëve të saj, të trajtohet në mënyrë të barabartë nga autoriteti komunal.

¹ Referojuni Rregullores 2000/45 të UNMIK-ut mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, neni. 21.1

Në Udhëzimin Administrativ (AI) 2003/2 të UNMIK-ut mbi udhëzimet procedurale për punën e komisioneve komunale për komunitete, e cila është promulguar nga Zëvendësfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (Z/PSSP-ja) më 15 tetor 2003, është ofruar një plan i përgjithshëm i rolit dhe udhëzimeve procedurale për KK-në.

II. Gjendja aktuale

Një vlerësim i për bashkët i zhvilluar kohët e fundit së nga DD i OMIK-ut dhe ZÇK-së së UNMIK-ut, tregon se që nga muaji shkurt i vitit 2004, KK-të janë formuar në 27 nga 30 komuna². Megjithatë, për një të tretën e tyre ose nuk janë emëruar ende anëtarët,³ ose nuk janë takuar - përveç me rastin e sesionit inaugurues⁴ - ose nuk takohen rregullisht⁵. Në komunat tjera, në të cilat janë formuar KK-të, të cilët përpiqen të takohen rregullisht, janë mbajtur dy apo më shumë takime, edhepse, me një progres shumë solid. Çështjet rrallë i janë përcjellur KM-së për shqyrtim⁶, i cili ka për detyrë t'i hetojë rastet, të cilat i dorëzohen për shqyrtim nga KK-ja.

Studimi i zhvilluar nga DD i OMIK-ut dëshmon se të metat e vërejtura vijnë nga çështjet që kanë të bëjnë me (1) *procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të KK-ve*, (2) *moskuptimin e drejtë të Rregullores 2000/45 të UNMIK-ut nga ana e anëtarëve të KK-ve* përkitazi me rolin dhe kompetencat e tyre dhe, rrjedhimisht, (3) *mungesën e përkushtimit nga ana e anëtarëve të KK-ve*, e kjo manifestohet me numrin e vogël të takimeve të KK-ve dhe mungesën e diskutimeve përmbajtësore gjatë këtyre takimeve. Këto tri forma janë shqyrtuar dhe analizuar në pjesën e ardhshme. Këto konstatime përbëjnë bazën për konkluzën dhe rekomandimet mbi planin e ardhshëm të veprimit për UNMIK-un dhe IPVQ-në.

III. Analiza e problemit

1. Sfidat në lidhje me procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të KK-ve

- *Subjektet politike ose nuk pajtohen me përbërjen e KK-ve, ose pranojnë ndonjë përbërje që bie ndesh me Rregulloren 2000/45 të UNMIK-ut.*

² Këto komitete nuk janë formuar ende në Glllogovc, Kaçanik/ and Malishevë.

³ Jo të gjitha komunitetet i kanë përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në Obiliq, Prishtinë, Mitrovicë and Fushë Kosovë. KK-ja në Gjakovë nuk ka kryesues.

⁴ Këto komuna përfshijnë Suharekën, Klinën, Vitinë, Fushë Kosovën, Podujevën, Dragashin dhe Vushtrrin.

⁵ Në Pejë, Gjiilan, Lipjan, Shtime, Klinë, Obiliq, Rahovec, Skenderaj, Kamenicë.

⁶ Gjithsej peë rekomandime u janë dërguar çdo KM-je në mbarë Kosovën. Dy rekomandime në lidhje me punësimin e romëve etnikë të Kosovës në shërbimin civil komunal dhe prerjen ilegale të pyjeve në zonat e banuara me pakica i janë dorëzuar për shqyrtim KM-së në Gjiilan. Një rekomandim i tillë përkitazi me çështjen e përdorimit të të dyja gjuhëve zyrtare të Kosovës në shenjat publike i është dorëzuar për shqyrtim KM-së në Rahovec. Një rekomandim në lidhje me kundërthëniet e bazuara në përkatësi iu dorëzua KM-së në Lipjan; një përkitazi me kthimin e një familjeje egjiptiane KM-së në Istog. Si Shtojë një kërkesë për përdorimin edhe të gjuhës shqipe, edhe asaj serbe në Shtërpçë, që iu dorëzua për shqyrtim kuvendit komunal.

KK-të duhet të themelohen me qëllim të garantimit të përfaqësimit të drejtë të komuniteteve dhe, si të tilla, nuk do të thotë se ato automatikisht duhet ta pasqyrojnë proporcionin e vendeve që subjektet politike i kanë në kuvendet komunale⁷. Sidoqoftë, procesi i emërimit të anëtarëve të KK-ve shpesh politizohet, posaçërisht kur kemi të bëjmë me përzgjedhjen e anëtarëve të kuvendeve komunale⁸. Si rrjedhojë, KK-të **shpesh shndërrohen në forume politike** dhe mjete proteste; anëtarët e emëruar shpesh nuk marrin pjesë në sesinet e KK-ve. Kjo pjesërisht shpjegon arsyen pse disa përfaqësues serbë të Kosovës dhe disa subjekte politike shqiptare të Kosovës⁹ që përfaqësohen në këto komitete hezitojnë të marrin pjesë në punën e KK-ve.

Lufta për pushtet në rradhët e komiteteve paraqitet përgjatë disa linjave ndarëse dhe merrë këto forma: atë të konkurrencës politike midis fraksioneve politike nga i njëjti komunitet etnik (p.sh. midis shumicës dhe pakicës, apo midis grupeve të ndryshme të pakicave), konkurrencës së brendshme midis subjektit të njëjtë politik, si dhe midis fraksioneve politike që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme etnike (më të përhapurat).

Një çështje tjetër e ndryshme politike që ka të bëjë me përbërjen e KK-së është nëse kryesuesi i KK-së duhet të jetë pjesëtar i komunitetit që është në pozitë të shumicës në kuvendin komunal, apo anëtar i komunitetit që është pakicë brenda territorit të komunës (bazuar në Rregulloren 2000/45 të UNMIK-ut, neni.23.3 c). Kjo çështje duhet të analizohet nga pikëpamja ligjore për kuvendet komunale në të cilat komuniteti pakicë që momentalishtë jeton në komunë mban shumicën e vendeve, si në Novobërdë p.sh.¹⁰.

- *Procesi i zgjedhjes së përfaqësuesve të komuniteteve është joadekuat, madje në disa raste rrezikon mbështetjen popullore ndaj anëtarëve të komiteteve.*

Shumë anëtarë të KK-ve **ose vetëmërohen, ose emërohen politikisht**, dhe rrjedhimisht ju mungon mandati i plotë demokratik që do duhej të buronte nga zgjedhësit e tyre. Për shembull, komunitetet në Prizren, Gjilan dhe Lipjan, kanë kundërshtuar emërimin e përfaqësuesve të vetë të zgjedhur. Arsyeja mund të hulumtohet në Rregulloren 2000/45 të UNMIK-ut. Përderisa me këtë rregullore parashihet se kuvendet komunale duhet t'i

⁷ Referojuni Rregullores 2000/45 të UNMIK-ut, neni.23.3.

⁸ Rregullorja 2000/45 e UNMIK-ut, neni.21.1 parasheh se kuvendi komunal duhet t'i emërojë anëtarët e KK-së. Statuti komunal duhet t'i rregullojë procedurat e emërimit të anëtarëve të KK-ve dhe KM-ve, duke u siguruar që në radhët e anëtarëve të KK-ve të ketë edhe anëtarë të kuvendit, edhe përfaqësues të komuniteteve [neni.23.3 (a)].

⁹ Për momentin PDK-ja po bojkoton pjesëmarrjen në KK në komunën e Vitisë (edhe pse më herët ka pranuar të marrë pjesë) derisa në ndërkohë sërëbët e Kosovës po bojkotojnë punën e KK në katër komuna tjera . PDK-ja në Klinë ka refuzuar që të marrë pjesë në KK me pretekstin se nuk është përfaqësuar në Bordin e Drejtorëve Komunal, dhe LDK-ja në Istog akoma nuk ka dhënë emërimin e anëtarit të vet në KK.

¹⁰ Siç u theksua më lartë, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, mbajnë shumicën e vendeve në kuvendin komunal (10 nga 17), ndërsa Kryetari i kuvendit komunal është serb. Deri para pak kohësh, kryesuesi i KK-së ishte serb i Kosovës, çfarë shkaktoi konfuzion të konsiderueshëm dhe pakënaqësi në radhët e anëtarëve shqiptarë të kuvendit komunal. Edhe pse në shikim të parë do të dukej se shqiptarët e Kosovës, të cilët tani jetojnë Novobërdë, kur llogarisim numrin e personave të zhvendosur brenda vendit (IPZHV-të), bëhet e paqartë se cili komunitet përbën vërtetë shumicën, e cili pakicën. Sidoqoftë, nuk ekzistojnë shifra të besueshme mbi numrin e popullsisë në këtë komunë. Më maj 2004, kryesia e KK-së së kësaj komune u fitua nga një shqiptar i Kosovës.

emërojnë të gjithë anëtarët e komiteteve¹¹, kjo rregullore nuk ofron udhëzime të hollësishme mbi mënyrën se si duhet të zgjedhen kandidatët, e as se si të sigurohen konsultimet me zgjedhësit e nivelit më të ulët. Për shkak të kësaj mungese të udhëzimeve, shumë komuna janë ballafaquar me pakënaqësi ndër radhët e qytetarëve. Komuna e Zveçanit, megjithatë, pati sukses në rrugën e saj të kërkimit të një zgjidhjeje të pranueshme dhe, më 20 dhjetor të vitit 2002, pas një fushate të gjerë për informim, u mbajtën zgjedhjet joformale për zgjedhjen e anëtarëve të KK-ve që nuk ishin anëtarë të kuvendit komunal.

Sa i përket përzgjedhjes së përfaqësuesve të komuniteteve, kuvendet komunale e kanë pasur vështirë t'i identifikojnë kandidatët e duhur për KK, të cilët do të ishin të aftë që në mënyrë profesionale të merren me homologët dhe komunitetet e tyre. Kur kuvendet komunale në fillim emëruan anëtarët e komiteteve të detyrueshme, roli dhe përgjegjësitë e KK-ve ishin të paqarta, për shkak të mungesës së modelit të rregullores së punës. Prandaj, duket se gjatë procesit të përzgjedhjes, përkushtimi dhe kualifikimi i kandidatëve për **KK** nuk janë shqyrtuar si duhet.

Më në fund, pjesëtarëve të komuniteteve pakica shpesh u mungojnë njohuritë mbi strukturat komunale dhe parimet themelore të “qeverisjes së mirë”. Kjo ka vënë përpara një sfidë të madhe, meqë ka pasur raste kur përfaqësuesit e njëjtë kanë qenë anëtarë të KK-së dhe KM-së në të njëjtën kohë. Duket qartë se këtu kemi të bëjmë me shkelje e dispozitave të Rregullores 2000/45 të UNMIK-ut, neni.23.3 (d) (i). Me këto të meta endemike, anëtarët e KK-së janë treguar hezitues që t'i pasurojnë njohuritë e tyre përmes aktiviteteve të veçanta të trajnimit, siç është Programi për Mbështetje Kuvendeve Komunale (PMKK-ja), moduli IV¹².

2. Mungesa e njohurive mbi rolin dhe kompetencat e KK-ve

Anëtarët e KK-ve nuk duket se e kuptojnë plotësisht qëllimin dhe fushëveprimin e KK-së dhe kjo ka ndikuar negativisht në punën e tyre. Si rezultat, kuvendet komunale tregojnë indiferencë apo refuzojnë të angazhohen aktivisht për ta ofruar ndihmën e tyre në mënyrë që të garantohet përmbushja efektive e rolit të KK-ve.

- *Lufta e brendshme për pushtet ndër radhët e përfaqësuesve të komuniteteve në komitetet e themeluara paraqet një sfidë shtesë.*

Anëtarët e kuvendeve pjesëtarë të shumicës dhe ata që nuk i përkasin asaj e shohin forumin si garë¹³, rrjedhimisht si diçka që e pengon efikasitetin e punës së komiteteve. Praktikant më të mira, sidoqoftë, dëshmojnë se komunitetet duhet të punojnë për interesin

¹¹ Përfshirë edhe anëtarët e kuvendit, edhe përfaqësuesit e komuniteteve, ndihmon të sigurohet që çdo komitet në komunë të përfaqësohet nga më së paku një anëtar në KK [Rregullorja 2000/45 e UNMIK-ut, neni. 23.3 (a), (b), (c)].

¹² Gjatë implementimit të MASP IV mbi “Rregulloren e punës së komiteteve për komunitete”, që është ofruar nga Ekipi i DD për Mbështetje Qeverisjes Lokale (LGST), pjesëmarrja në Gjilan, Dragash dhe Suharekë ishte e ulët.

¹³ Si shembull mund ta marrim komunën e Prishtinës.

më të mirë të komunës dhe banorëve të saj. Prandaj, përcjellja e kësaj ideje anëtarëve të komuniteteve për komunitete do të vazhdojë të mbetet pjesë e aktiviteteve të OMIK-ut.

- *Disa komuna vazhdojnë të injorojnë domosdoshmërinë e zbatimit të Rregullores 2000/45 të UNMIK-ut, prandaj ende si themelojnë komitetet për komunitete (KK-të)*

Në komunat monoetnike të Gllgovcit dhe Kaçanikut, KK nuk janë formuar meqë formimi i tyre do të ishte artificial dhe vetëm do të shtonte barrën financiare të komunës. Sidoqoftë, zhvillimet e fundit tregojnë një ndryshim të këtij mendimi. Ngjashëm, edhe në Malishevë, Kryetari i Komunës dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal nuk e shohin relevant emërimin e anëtarëve të komiteteve për komunitete, edhe pse kuvendet komunale të këtyre komunave zyrtarisht e kanë konfirmuar ekzistimin e komiteteve për komunitete. Ka vetëm 29 banorë romë të Kosovës, të cilët përbëjnë një komunitet në komunë, dhe që, sipas Kryetarit të Komunës, nuk kanë shfaqur interesim për të marrë pjesë në qeverisjen lokale. Megjithatë, sipas Rregullores 2000/45 të UNMIK-ut¹⁴, KK-të duhet të formohen, pavarësisht nga madhësia apo natyra e komunitetit, meqë diskriminimi mund të ndodhë për shumë shkaqe, përfshirë këtu edhe përkatësinë etnike.

Duhet të ritheksohet se të drejtat e komuniteteve janë garantuar me Kornizë Kushtetuese, me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4, kreu 4, ku komunitetet janë definuar edhe si etnike, fetare dhe gjuhësore.

3. Mungesa e përkushtimit të anëtarëve të KK-ve manifestohet në takime të rralla dhe mungesë të diskutimeve thelbësore gjatë sesioneve të KK-ve.

Anëtarët e KK-ve, shpesh të papërvojë, janë të pasigurtë për përgjegjësitë, çfarë shpjegon mungesën e motivimit për të marrë pjesë në sesionet e KK-ve dhe mosposedimit të një qasjeje proaktive në identifikimin dhe trajtimin e brengave të komuniteteve.¹⁵ Shkalla e ultë e pjesëmarrjes dhe involvimi i tyre i dobët nënkupton se ata shpesh vijnë të papërgatitur në mbledhjet e KK dhe, si rrjedhojë, nuk punojnë me efikasitet. Korrigjimi i kësaj të mete duhet të fillojë me organizimin e dhe planifikimin e duhur të mbledhjeve, si dhe me lajmërimin me kohë të anëtarëve për orarin¹⁶, vendin dhe rendin e ditës së takimeve. Një shembull ilustrues është komuna e Zveçanit ku KK-ja është ballafaquar me një varg problemesh organizative, për shkak të moskuptimit të duhur të rolit të administratës lokale. Me sa duket, edhe pse KK-ja takohej rregullisht, nuk ka pasur arkivim, mbajtje të procesverbalit, përkthim apo shpërndarje të duhur të informacionit derisa ky problem u zgjodh si rezultat i trajnimeve në kuadër të PMKK-së IV¹⁷ të ofruar

¹⁴Shiko Rregulloren 2000/45, S.23.1 dhe 5 të UNMIK-ut dhe UA 2003/002 Udhëzimet procedurale për punën në komitetet komunale për komunitete, 3.1 dhe 3.3 (b).

¹⁵ Në një numër të komunave, gjegjësisht në Gjilan, zyrtari lokal për komunitete pranë UNMIK-ut është ai që ngrit çështje dhe nxit diskutime dinamike midis anëtarëve të KK-së, të cilëve u mungon iniciativa për ta filluar diskutimin mbi çështjet e komuniteteve.

¹⁶ Shih Rregulloren 2000/45 të UNMIK-ut, neni.15.3, “Së paku shtatë ditë pune para çdo mbledhjeje të Kuvendit Komunal apo tri ditë pune në raste emergjente...”

¹⁷ Shih fusnotën 13.

nga DD i OMIK-ut. Për më tepër, vështirësitë shfaqen edhe si pasojë e lirisë së kufizuar të lëvizjes së anëtarëve të komiteteve për komunitete.

Liria e lëvizjes për komunitetet enike, punësimi, apo përdorimi i gjuhës së tyre amtare, janë çështjet kryesore që i referohen KK-ve. Por, këto çështje janë diskutuar jashta kontekstit, meqë ende mungojnë diskutimet përmbajtësore që orientohen në raste konkrete, ndërsa takimet rrallë përfundojnë me ndonjë rezultat konkrete apo me trajtim të vazhdueshëm të çështjeve të diskutuara më parë. Për më tepër, meqë kemi pasur vetëm disa takime në vitin 2003, komisionet nuk kanë qenë në gjendje që në mënyrë sistematike t'i adresohen çështjet e ngritura. Për këtë arsye KK-të deri më tani ua kanë dorëzuar vetëm gjashtë rekomandime të gjitha komiteteve për ndërmjetësim në mbarë Kosovën.¹⁸ Ana tjetër më pozitive është se disa anëtarë të KK-ve duken sa janë më të interesuar në hulumtimin e çështjeve që ngriten në mbledhje. Vizita në terren janë organizuar në Pejë (për ta një zënkë midis dy familjeve perkatësish të ndryshme etnike), Shtërpçë (për ta vlerësuar gjendjen e një shkollë të përkohshme shqipe) dhe Prishtinë/Priština (ku anëtarët e KK-së vizituan komunitetin turk dhe ashkali dhe mbajtën një takim me boshnjakët e Kosovës).

IV. Konkluzione dhe rekomandime

Gjashtëmbëdhjetë muaj pas zgjedhjeve komunale të tetorit të vitit 2002, KK-të kanë stagnuar paksa në rrugën e tyre drejt të qenit funksionale. Me përjashtim të disa komunave ku KK-të janë themeluar dhe mbajnë takime të rregullta, KK-të akoma nuk janë institucionalizuar dhe vështirë se mund të konsiderohen si mjet të dobishme për advokimin e të drejtave të komuniteteve brenda territoreve të komunave përkatëse. Është nevojë urgjente që KK-ve t'u ofrohet ndihmë, në mënyrë që më mirë ta kuptojnë rolin dhe përgjegjësi të tyre dhe që autoritetet komunale ta njohin rolin e anëtarëve të këtyre komiteteve. Trajnimet e mëtejshme dhe njohja e anëtarëve të KK-s me udhëzimin administrativ 2003/2 duhet dyfishuar me ofrim konstant të këshillave. Për t'i kuptuar rolet dhe përgjegjësitë e tyre, anëtarët e KK-ve duhet ta kuptojnë qëllimin e KK-së, dhe, çka është me rëndësi themelore, domethënien e fjalës "diskriminim". Për ta mundësuar zgjidhjen e këtyre çështjeve, DD i OMIK-ut do të dëshironte të propozojë si vijon:

1. Organizimin e tryezave të rrumbullakta për diskutime apo ndërmjetësime në komunitet, të cilat ballafaqohen me vështirësi në krijimin e KK-ve funksionale.

Në komunitet ku KK-të nuk janë formuar ende, aktivitetet mbështetëse duhet të përqëndrohen në zhvillimin e aftësive negociuese të anëtarëve të kuvendeve komunale, në mënyrë që ata të jenë të aftë të arrijnë një marrëveshje mbi formimin dhe përbërjen e KK-së përkatëse. Kjo ishte një nga objektivat e mbledhjes së kuvendit komunal të Kaçanikut, që u organizua nga Zyra e OMIK-ut në Shtërpçë, organizuar nga Zyra e OMIK-ut në

¹⁸ Shih fusnotën 7

Shpërcë dhe mbajtur më dhjetor 2003 në Strugë (IRJM).¹⁹ Përmes komponenteve pjesëmarrëse dhe interaktive siç janë takimet në grupe më të vogla dhe aktivitetet e “aktrimit”, takimi pati për qëllim ta lehtësojë dialogun dhe shërbeu si katalist për përmirësimin e funksionimit të kuvendit komunal dhe komisioneve të tij. Takimi i Kaçanikut do të mund të përdoret si model në planifikimin e aktiviteteve të ngjashme të ndërmjetimit në të ardhmen.

Në komunat ku KK-t janë formuar por nuk janë funksionalizuar, OmiK-u dhe UNMIK-u duhet vazhduar së organizuari diskutimet e tryezave të rumbullakta dhe takimet ndërmjetësuese me zyrtarët komunal, anëtarët e KK-ve dhe përfaqësuesit komuniteteve. Këto lloj aktiviteteve janë dëshmuar si të suksesshme në Zubin Potok/Zubin Potok²⁰ me ç rast u arrit pajtimi që të takohen rregullisht.

Përveç kësaj, në komunat në të cilat është emëruar nënkryetar tjetër i kuvendit komunal²¹, ai/ajo duhet të involvohet në punën e KK-së, meqë përkrahja organizative e tij dhe kontributi i njohurive procedurale mund të jenë shumë i çmueshme për funksionimin e suksesshëm të KK-së²².

2. Shtimi maksimal i pjesëmarrjes efektive në mesin e komuniteteve

Sigurimi që të gjitha komunitetet, përfshirë edhe komunitetin shumicë, janë të vetëdijshëm për mënyrën e funksionimit të KK-ve dhe mbi se ata do të duhej t’i qaseshin atij, do ta lozte një rol thelbësor në forcimin e rolit të KK-ve. Takimet publike, debatet mediale dhe fushatat e vetëdijësimit duhet të zhvillohen në atë mënyrë që të jetë në gjendje të njohë opinionin publik me mënyrat si t’i shfytëzojnë KK-të për t’i mbrojtur dhe promovuar të drejtat e tyre. Përpjekje të veçanta duhet bërë që të KK-të paraqiten konkretisht dhe thjeshtësisht të përputhshme me kontekstet lokale duke thjeshtësuar aq sa ka mundësi mënyrat sesi brengat e komuniteteve të kanalizohen përmes KK-ve. Qendrat për komunitete prane OMiK-ut mund të shërbejnë si vende për organizimin e mbledhjeve apo tryezave të rumbullakëta të KK-ve dhe kjo mund të organizohet në bashkëpunim me udhëheqesit e takimeve të fshatit. P.sh Qendra për Komunitetin e OMIK-ut në Veliko Ropotova të madhe, komuna e Kamenicës organizon takime mujore me përfaqësuesit serb të fshatit në Kosovë për çështje përkatëse të komunitetit lokal. Në

¹⁹ Pas konfliktit politik që zgjati 6 muaj, nga shkurti 2003 deri më gusht 2003, mbledhja e sërishme mbledhi me sukses 29 nga gjithsejt 31 anëtarët e kuvendit komunal dhe shërbeu si forum për t’i evituar dallimet dhe për të krijuar praktikën e bashkëpunimit.

²⁰ Në Zubin Potok, përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut thirri një takim të jashtëzakonshëm më 13 nëntor 2003 për të diskutuar arsyet pse komiteti i themeluar për komunitete dhe ai për ndërmjetësim një pauzë katër mujore sa u përket mbledhjeve.

²¹ Shiko Rregulloren 2000/45, S.25.3 të UNMIK-ut “Në komuna ku një apo më shumë komunitete jetojnë e që nuk janë shumicë, një nënkryetar shtesë do të emërohet nga Kuvendi Komunal për këto komunitete”.

²² Një shembull i involvimit të nënkryetarit shtesë në zgjedhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me KK ka ngjarë në Prishtinë, ku KK është ballafaquar me konfliktet e vazhdueshme mbi emërimet e serbeve të Kosovës për anëtarë të KK. Dhe si rezultat i takimit që OmiK-u mbajti më 23 dhjetorë 2003 Nënkryetari i dytë nga komuniteti serb u pajtua që të marrë pjesë në takimet e përdymuajshme të KK si vëshgues.

këtë forum publiku informohet mbi aktivitetet e KK-së dhe ka mundësinë që t'u drejtohet dhe të takohet me anëtarët e KK-së.

3. Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të KK-s për të siguruar shfrytëzim optimal të mekanizmave të KK-s

Anëtarët e Komisionit kanë nevojë edhe për udhëzime, dhe për trajnime. Përderisa udhëzimet ekzistojnë në UA 2003/002, trajnimet dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve janë procese që po vazhdojnë. Puna e DD të OMiK-ut është përqëndruar në implementimin e PMKK 4²³, tok me aftësimin mbi çështjet procedurale. Praktikrat më të mira kanë treguar se takimet pasuese relevante dhe të pavarura për secilin aktivitet përmes “monitorimit, këshillimit dhe përparimit”, janë kryesore për zhvillimin e KK-ve.

Sigurimi i aktiviteteve pasuese mund të jetë në forma të ndryshme, ndërkohë që qasja creative është esenciale. P.sh KK-ja në Lipjan/Lipljan ka formuar 3 nën-grupe, të cilat mirren me të drejtave të qytetarëve dhe diskriminimin, monitorimin e punës së Kuvendit Komunal, dhe shqyrtimit të ankesave të qytetarëve. Edhe pse për momentin puna e Komisionit ngel e ngrirë për arsye politike²⁴, krijimi i grupeve të specializuara është hap i avancuar.

Takimet një nga një me anëtarët e Komisionit të organizuara nga Ekipi për Përkrahje qeverisjes lokale pranë Departamentit të Demokratizimit është dëshmuar e sukseshme në Štrpce/Shtërpçë dhe tani po implementohet në Ferizaj/Uroševac. DD pranë OMiK-ut në Pejë/Peć ka organizuar një sërë seminaresh për anëtarët e KK-s në rajon, ku pjesëmarrësit diskutuar çështjet që i mundojnë dhe mënyrat që mund ti qasin për ti zgjedhur²⁵.

Përveq kësaj duhet të inkurajohen dhe të ndihmohen këmbimet mes anëtarëve e KK-ve nga komunat fqinje. Kjo qasje ka gjasa të stimulohet më shumë meqë vie deri tek shkëmbimi i ideve dhe “praktikave më të mira”, me çrast u mundësohet anëtarëve të KK-s të mësojnë nga komunat me KK më të zhvilluara²⁶.

4. Përfshirja e UA 2003/002 në Statutin Komunal

Nevojitet inkurajuar posedimi lokal i UA 2003/002, dhe mënyra më efikase për të bërë një gjë të tillë është përfshirja e tij plotësisht apo pjesërisht në Statutin Komunal. Aq më shumë meqë UA 2003/002 për momentin është dokument jo detyrues përfshirja e tij në Statutin Komunal do të rris fuqinë e tij.

²³ Shiko fusnotën 13.

²⁴ Që nga formimi i nëngrupeve punuese të KK më 9 tetor 2003 në [Lipjan/Lipljan](#) ata janë takuar vetëm njëherë. Një problem serioz ka dal nga fakti që Kryesuesi i LL i cili është edhe nënkryetari i dytë nga komuniteti serb nuk gëzon përkrahjen e udhëheqësve të fshatit serb të Kosovës.

²⁵ Seminaret janë organizuar me kërkesën e anëtarëve të KK të cilët shprehen vullnetin për të vazhduar të ndajnë mendimet e tyre mbi KK dhe të përforcojnë punën mbrenda Kuvendit Komunal.

²⁶ P.sh në regjionin e Gjilanit, anëtarët e KK nga katër komunat janë takuar më 4 dhjetor 2003 për të marrë pjesë në MASP IV. Ky lloj takimi do të mund të organizohet më vonë pas trajnimit.

Zyra Këshillimore e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve pranë IPVQ-ve do ta vazhdojë aftësimin e kuadrove të komiteteteve për komunitete përmes sesioneve të informimit mbi “Rolin e Qeverisë Lokale në implementimin e konventave të përzgjedhura ndërkombëtare”, disa prej të cilave tashmë janë mbajtur në pesë rajone të Kosovës. Kur kemi të bëjmë me çështjet që ndërlidhen me të drejtat dhe interesat e komuniteteve, ZKK gjithashtu kryen edhe një funksion ndërlidhjeje midis qeverisë dhe komunave.

DD i OSBE-së do të vazhdojë t’u ofrojë trajnime dhe këshilla komiteteteve të komuniteteve, duke u bazuar në modulën e trajnimeve që tani më janë ofruar në 15 komuna.

5. Përforcimi i bashkëpunimit mes shtyllës së II dhe të III për çështjen e Komisioneve për Komunitete KK -ve

Vështirësitë që kanë të bëjnë me caktimin dhe funksionimin e KK-ve flasin për nevojën e bashkëpunimit më të ngushtë dhe koordinimit të përmirësuar mes Shtyllës së Dytë (UNMIK) dhe Shtyllës së III (OMiK). Kjo do të duhej të fillonte me konsolidimin e në pozite të përbashkët mbi çështjen e KK-ve. Sigurimi i bashkëpunimit mes OMiK/UNMIK për të ndihmuar aktivitetet e përditshme të KK-ve është qnësore për tju shmangur qasjeve kontradiktore dhe siguruar përkrahje adekuate këtij mekanizmi crucial për integrim të sukseshëm të të gjitha komuniteteve.